

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXII, nr. 6562  
E premte, 18 mars 2022  
çmimi 0.40 €

Ministri i Shëndetësisë:  
Covid-19 është i pranishëm  
dhe nuk ka kaluar | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"



PROKURORI I SPECIALES KA KËRKUAR DËNIMIN E HYSNI GUCATIT DHE NASIM HARADINAJT, MBROJTJA LIRIMIN E TYRE | FAQE 4-5

## GUCATI DHE HARADINAJ MBROJNË LUFTËN E UÇK-së, KËRKOJNË DREJTËSI ME FAKTE



Kryetari i Organizatës së Veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK), Hysni Gucati dhe nënkryetari Nasim Haradinaj, janë deklaruar të pafajshëm në fjalën përfundimtare në seancën gjyqësore në Gjykatën Speciale. Ata kanë deklaruar se i janë bashkuar UÇK-së për ta mbrojtur popullin e tyre dhe kanë kërkuar nga trupi gjyqësor vetëm drejtësi me fakte

## Bideni e quan Putinin 'kriminel lufte'



INTERVISTË ME PROFESORIN ANTON PANÇEV

## PANÇEV: KOSOVA E KA MBËSHTETJEN E BULLGARISË NË RRUGËN EUROATLANTIKE

| FAQE 4-5

### AKTUALE



ZELENSKY, SCHOLZIT: RRËZOJENI MURIN QË PO KRIJON RUSIA! | F. 2

KMDLNJ: MOSVOTIMI I KODIT CIVIL, LOJË POLITIKE E POZITËS DHE OPOZITËS | F. 7

DEDAJ DHE BISLIMI U PRITËN NË PARLAMENTIN E ZVICRËS NË BERN | F. 6

### EKONOMI



KURTI THOTË SE QEVERIA MBETET E PËRKUSHTUAR PËR HARTIMIN DHE ZBATIMIN E POLITIKAVE SOCIALE | F. 8

KËRROHET PARABURGIM NDAJ DY TË DYSHUARVE NË RASTIN "BREZOVICA" | F. 8

### SPORT



ADEMI, PAS LIRIMIT: DEBATI VERBAL NË FFK U SHFRYTËZUA NGA GRUPET E INTERESIT | F. 10

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni Xhepçisht - Tetovë Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 735  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@ml.net.mk](mailto:renova@ml.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.PC  
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE  
INFO: 049-111-101, 044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjbiznesi.com](http://www.kolegjbiznesi.com)  
info@kolegjbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website, Marketing...



# Bideni e quan Putinin 'kriminel lufte'

WASHINGTON, 17 MARS - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, për herë të parë e ka quajtur "kriminel lufte" presidentin e Rusisë, Vladimir Putin. Deri më tani administrata e Bidenit kishte shmangur përdorimin e kësaj fraze. Duke folur për gazetarët pas një ngjarjeje në Shtëpinë e Bardhë të organizuar, Biden tha: "Mendoj se ai është kriminel lufte". Pas komenteve të presidentit Biden për Putinin, agjencia ruse

e lajmeve TASS raportoi se Kremli i ka cilësuar këto deklarata të presidentit amerikan si të "paprane dhe një retorikë e pafalshme". Më herët, gjatë së mërkurës, sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, tha se ShBA-ja po "shikonte me kujdes" për të përcaktuar nëse forcat ruse po sulmojnë me qëllim caqe civile. Ukraina i ka kërkuar Gjykatës në Hagë që ta hetojë Rusinë për krime lufte.

E pyetur që t'i shpjegojë më tej komentet e presidentit, zëdhënësja e Shtëpisë së Bardhë, Jen Psaki, tha se Bideni "po fliste nga zemra dhe po fliste nga ajo që ka parë në televizion, që janë veprime barbare nga një diktator brutal përmes pushtimit të tij të një shteti të huaj". Megjithatë, ajo shtoi se "një proces ligjor" për t'i hetuar pretendimet e krimeve të luftës "po vazhdon në Departamentin Amerikan të Shtetit".



# Osmani kërkon ndihmën e ShBA-së për anëtarësimin e Kosovës në NATO

PRISHTINË, 17 MARS - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë, në një letër dërguar presidentit amerikan Joe Biden, se integrimi euroatlantik i Kosovës është prioritet kyç i sigurisë kombëtare. Letra, e cila është siguruar të enjten, më 17 mars, mban datën e 10 marsit. "Evropa është duke u përbashkuar me kohët më të errëta dhe më të rrezikshme prej përfundimit të Luftës së Ftohtë. Teksa ndajmë synimin e përbashkët për mbrojtje dhe promovim të sigurisë globale, anëtarësimi i Kosovës në NATO është bërë domosdoshmëri. Argumentet kundër anëtarësimin të Kosovës në NATO shpërfillin këtë nevojë për siguri në Ballkanin Perëndimor dhe nuk shërbejnë në interes të botës së lirë demokratike, e cila është duke u



rrethuar nga tendenca autoritare dhe politikat e tyre agresive". Sipas Osmanit, Kosova ka dëshmuar disa herë pse meriton të jetë pjesë e

Aleancës Veriatlantike dhe ka përmendur se Kosova është shteti më pro-amerikan dhe më pro-NATO në botë. Ajo ka thënë se beson që ShBA-

ja do ta shfrytëzojë lidhshipin dhe ndikimin që ka për ta mbështetur Kosovën drejt anëtarësimin në NATO, duke nisur nga programi i Partneritetit për Paqe dhe anëtarësimi i plotë në Kartën e Adriatikut. "Ndonëse të gjithë sytë janë drejtpërdrejt në luftën shkatërruese në Ukrainë, ne nuk duhet ta humbim vëmendjen ndaj situatës së brishtë në Ballkan. Ne jemi të ekspozuar nga përpjekjet e vazhdueshme të Rusisë për ta minuar Kosovën dhe për ta destabilizuar gjithë Ballkanin Perëndimor", ka thënë Osmani. NATO-ja ka 30 vende anëtare. Nga vendet e rajonit, pjesë e saj janë: Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi. Më 9 mars Qeveria e Kosovës ka marrë vendim për themelimin e grupit punues ndërinstitucional

për anëtarësimin e Kosovës në NATO. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se objektivi kryesor i këtij grupi do të jetë avancimi i procesit të integritimit në NATO, fuqizimi i pranisë së Kosovës në organizata dhe mekanizma rajonale dhe ndërkombëtare të sigurisë, si dhe bashkëpunimi me aleatët strategjikë ndërkombëtarë. Më 6 mars anëtari i Dhomës së Përfaqësuesve në ShBA, demokrati Ritchie Torres, ka kërkuar nga presidenti Biden që Kosova të bëhet anëtare e NATO-s. Në një letër dërguar presidentit Biden dhe sekretarit amerikan të Shtetit, Antony Blinken, kongresisti Torres ka thënë se pas pushtimit rus në Ukrainë, Uashingtoni duhet t'i ndihmojë Kosovës për anëtarësim në NATO.

# Zelensky, Scholzit: Rrëzojeni murin që po krijon Rusia

KIEV, 17 MARS - Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky ka mbajtur një fjalim emocional para Parlamentit gjerman të enjten, duke bërë thirrje për "rrëzim" të murit që Rusia është duke ndërtuar për ta ndarë Evropën përmes pushtimit të Ukrainës. "Nuk është Mur i Berlinit. Është mur në Evropën Qendrore, në mes të lirisë, dhe ky mur po rritet me çdo bombë" të rrëzuar në shtetin tonë, ka thënë Zelensky para deputetëve gjermanë më 17 mars. "Zoti Scholz, rrëzojeni këtë mur!", ka thënë ai duke iu referuar kancelarit gjerman Olaf Scholz. Kjo thirrje ka qenë e ngjashme me atë të ish-presidentit amerikan Ronald Reagan, në

fjalimin e vitit 1987 para Portës Brandenburg, kur ka sfiduar homologun e tij sovjetik, Mikhail Gorbachev, që ta bëjë të njëjtën gjë. Ky fjalim i Zelenskyt është i radhës pas fjalimeve të ngjashme që ai ka mbajtur në Kanada, Britani dhe Shtetet e Bashkuara, duke bërë thirrje për më shumë mbështetje që të mposhtet agresioni rus. Lideri ukrainas i ka bërë thirrje Berlinit që ta mbështesë Ukrainën në kërkesën për anëtarësim në Bashkimin Evropian, por edhe e ka qortuar pse nuk ka vepruar shpejt për ta anuluar pjesëmarrjen në projektin e gazsjellësit, Rrjedha Veriore 2, ndonëse ka pasur shenja se pushtimi do të

ndodhte. "Ekonomi, ekonomi, ekonomi", ka qenë përgjigja ndaj thirrjeve të Ukrainës që projektin të rrëzohet, ka thënë Zelensky. Gjermania ka pezulluar projektin, i cili kishte synim që ta rriste sasinë e gazit që do të shkonte nga Rusia në Gjermani. Scholz ka njoftuar për anulim të projektit më 22 shkurt, pasi presidenti rus, Vladimir Putin, ka deklaruar se e njëjta pavarësinë e dy rajoneve ukrainase, Donjeck dhe Luhansk. Më shumë se tre milionë njerëz kanë ikur nga Ukraina prej kur presidenti rus, Vladimir Putin, urdhëroi pushtimin e Ukrainës më 24 shkurt.



PROKURORI I SPECIALES KA KËRKUAR DËNIMIN E HYSNI GUCATIT DHE NASIM HARADINAJT, MBROJTJA LIRIMIN E TYRE

# Gucati dhe Haradinaj mbrojnë luftën e UÇK-së, kërkojnë drejtësi me fakte



Kryetari i Organizatës së Veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK), Hysni Gucati dhe nënkryetari Nasim Haradinaj janë deklaruar të pafajshëm në fjalën përfundimtare në seancën gjyqësore në Gjykatën Speciale. Ata kanë deklaruar se i janë bashkuar UÇK-së për ta mbrojtur popullin e tyre dhe kanë kërkuar nga trupi gjyqësor vetëm drejtësi me fakte

**HAGË, 17 MARS** - Kryetari i Organizatës së Veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK), Hysni Gucati, në fjalën përfundimtare të mbrojtjes gjatë seancës gjyqësore në Gjykatën Speciale, është ngritur në këmbë në mbrojtje të luftës çlirimtare. Gucati ka thënë se çdo sugjerim që është bërë ndaj UÇK-së që është organizatë kriminale është absurde, e pavërtetë dhe është fyerje për dëshmorët e lirisë. “Çdo sugjerim që është bërë ndaj UÇK-së, se është ‘organizatë kriminale’, është absurde, e pavërtetë dhe fyerje për dëshmorët e lirisë”, ka thënë Gucati, duke theksuar se UÇK-së i është bashkuar për ta mbrojtur atdheun dhe popullin e Kosovës nga regjimi i Sllobodan Millosheviqit. “Do të luftoj çdo ditë për të drejtat e popullit tim. Në vitin 1997 unë dhe bashkëmoshatarët e mi u jemi bashkuar UÇK-së. Këtë e kam bërë për ta mbrojtur atdheun tim, popullin tim dhe Kosovën”, është shprehur Gucati.

Nënkryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Nasim Haradinaj, është deklaruar tërësisht i pafajshëm për akuzat

që rëndojnë mbi të nga Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) në Hagë. Haradinaj në fjalën e tij ka adresuar akuza të rënda në drejtim të ZPS-së. Ai e ka krahasuar ZPS-në me prokuroritë diktatoriale, të cilat kanë qenë në ish-Jugosllavi.

Më tutje, ai i është kundërpërgjigjur prokurores Valeria Bolici, e cila e ka quajtur ditë më parë kriminel. “Prokurorja Valeria Bolici e mori fjalën paturpësisht dhe me harbutëri na tha se jemi kriminelë. Ajo duket e zemëruar me mungesën e fakteve dhe tani po flet. Ajo duhet ta dijë që ne edhe në këto momente e kemi prezumimin e pafajësisë. Ajo vetëm duhet ta kujtojë që ne asnjëherë nuk kemi bashkëpunuar me kriminelë siç ka bërë ajo dhe prokuroria”, ka thënë Haradinaj.

Gjatë fjalës së tij, Haradinaj ka pasur edhe disa fjalë për kryeprokurorin e ZPS-së, Jack Smith. “Thashë mos po i mbetet hatri Jack Smithit. Z. Smith tha dy çështje. E para, tha ata kanë pasur interes personal. Z. Prokuror, mua më njohin të gjithë dhe e dinë që kjo është gënjeshtëri. Po ta kisha

shikuar interesin personal, nuk do të isha as në luftë dhe as këtu. Kjo ty të duhet që të diktosh dhe të impenjohesh në marrjen e vendimit të këtij paneli. Unë nga trupi gjyqësor kërkoj vetëm drejtësi dhe vendim me fakte”, është shprehur Haradinaj.

Prokurori i Gjykatës Speciale, Jack Smith, i ka kërkuar trupit gjyqësor që t’i shpallë fajtor Hysni Gucatin dhe Nasim Haradinajn pasi, sipas tij, “ata kanë kryer krim dhe se nuk janë penduar për një gjë të tillë”. Ai ka thënë se dënimi ndaj tyre do t’i parandalonte veprimet e tyre të ngjashme në të ardhmen si dhe veprimet e njerëzve të tjerë në Kosovë që, sipas tij, synojnë të pengojnë punën e Gjykatës Speciale.

Në kohën kur po bëhen parashtrimet për masën e dënimit, prokurori i Specializuar ka thënë se çështja gjyqësore ndaj krerëve të OVLUÇK-së është e rrallë dhe, sipas tij, nuk lë dyshim lidhur me synimin e tyre për ta kryer veprën penale me dashje. “Fajësia e të akuzuarve është provuar dhe tani na mbetet të vendosim se cila do të jetë masa e dënimit. Këta të akuzuar janë unikë, sepse ata nuk janë penduar. Ata kanë shkuar më tej duke thënë se do ta bëjnë këtë krim apo një krim të ngjashëm po t’u jepej mundësia edhe në të ardhmen. Po të mos mjaftonte kjo, është çështje shumë e rrallë në çdo juridiksion që të keni përpara dy individë që janë fanatikë dhe të angazhuar për të shkuarën e tyre penale dhe që e kanë thënë

shumë qartë atë. Do të duhej që këtyre t’u jepej një masë dënimi me burg shumë e madhe, me qëllim që të mos insistojë asnjë shpresë që të shkatërrohet kjo gjykatë”, ka thënë Smith. Ai ka përsëritur se në Kosovë ekzistojnë njerëz që synojnë ta pengojnë punën e gjykatës. Më tutje, ai ka thënë se vendimi për dënimin e Gucatit dhe Haradinajt duhet të shqiptohet në përputhje me krimin. Smithi ka thënë se të gjitha veprimet e Gucatit dhe Haradinajt ishin me qëllim të arritjes së qëllimit të tyre, sipas tij, për ta shkatërruar Gjykatën Speciale.

Ekipe mbrojtëse të drejtuesve të Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së u janë kundërpërgjigjur deklaratave të Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS), duke thënë se Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj kanë vepruar në interes të publikut dhe se të njëjtët duhet të shpallen të pafajshëm.

Pasi prokuroria ka deklaruar se të akuzuarit kanë ndërmarrë veprime me dashje konkrete dhe, sipas ZPS-së, të njëjtët duhet të shpallen fajtorë, mbrojtja e tyre ka kërkuar nga trupi gjyqësor vendim të pavarur dhe mbështetur në analizën objektive të ligjit.

Avokati i Hysni Gucati, Jonathan Elystan Rees, ka thënë se klienti i tij duhet të shpallet i pafajshëm. “Një ndër elementet që ata ngrenë është dashja konkrete, qëllimi konkret, ndërkohë ne bëjmë dhe parashtriam qëndrimin tonë. Ne bëjmë dallimin në mes të synimit konkret dhe synimit eventual dhe,

në fakt, e gjithë çështja e tyre mbështetet në këtë element, që zotëri Gucati, klienti im, ka vepruar me dashje konkrete, dhe unë i bëj thirrje trupit gjyqësor që të marrë këtë qasje, pra ta mbajë përgjegjës ZPS-në lidhur me këtë çështje, për këtë që është bishti kryesor i çështjes së tyre. Pra ata duhet që ta provonin çështjen e tyre, sepse ata kanë ngritur akuzat, pra ata e ngritën fabulën e çështjes që ata thonë se e kanë provuar, dhe nëse ata e kanë provuar përtej dyshimit të arsyeshëm, atëherë ju do ta merrni vendimin, por nëse ky nuk është rasti, atëherë trupi gjyqësor duhet që ta ndalojë gjykimin”, ka thënë Rees. Ai ka theksuar se ZPS-ja duhet të dëshmojë përtej dyshimit të arsyeshëm nëse ka pasur synime apo dashje konkrete nga të akuzuarit, në të kundërtën duhet shpallur pafajësinë.

Edhe avokati i Nasim Haradinajt, Toby Cadman, ka deklaruar se të gjitha veprimet e të akuzuarve lidhur me dosjet e arritura në OVLUÇK kanë qenë në interes të publikut. “Zoti Howling (prokurori) u përpoq që të fliste mbi klimën e frikës me qëllim që ta justifikonte punën e tij, por ajo që do të thoshim ne është se këtu bëhet fjalë për një nxjerrje në interes të publikut, e motivuar si duhet për ta parandaluar padrejtësinë. Ne i përmbahemi qëndrimit se interesi publik është i rëndësishëm”, ka thënë Cadman, duke kërkuar nga trupi gjyqësor që ta trajtojë interesin publik derisa është në kërkim të së vërtetës.





INTERVISTË ME PROFESORIN ANTON PANÇEV

## Pançev: Kosova e ka mbështetjen e Bullgarisë në rrugën euroatlantike

Anton Pançev ka studiuar në Universitetin e Sofjes “Shën Kliment Ohridski”, ku ka mbaruar studimet në Degën e Shkencave Politike (1997-2003, master) dhe Degën e Ballkanistikës (2000-2005, master). Në vitin 2013 e ka mbrojtur disertacionin me temë për zhvillimet politike në Shqipëri pas vitit 1991 dhe e ka marrë titullin doktor i shkencave politike. Nga viti 2009 është profesor asistent në Degën e Ballkanistikës, në të cilën ligjeron shqip dhe disa lëndë zgjedhëse për zhvillimet politike në Ballkan. Ka mbi 60 punime shkencore në shqip, bullgarisht dhe anglisht, të botuara në disa vende, në të cilat trajtohen marrëdhëniet bullgaro-shqiptare nga pikëpamje historike, politike dhe gjuhësore. Ka marrë pjesë në mbi 40 konferenca shkencore në Bullgari dhe në vende të tjera. Ka përkthyer 10 libra nga shqip në bullgarisht dhe anasjelltas dhe shumë tekste të tjera. Merret edhe me analiza politike për gazeta dhe revista, ku në fokus janë marrëdhëniet bullgaro-shqiptare. Nga viti 2013 është anëtar i Institutit Shkencor Maqedonas në Sofje, që është themeluar në vitin 1923 nga intelektualë të shquar bullgarë nga Maqedonia me qëllim mbrojtjen e trashëgimisë historike, kulturore dhe shpirtërore bullgare në territorin historik të Maqedonisë. Flet anglisht, rusisht, shqip dhe kupton greqisht dhe rumanisht.

nga stabiliteti i përgjithshëm i vendeve të rajonit, si edhe nga politika e shteteve perëndimore, e Bashkimit Evropian dhe e NATO-s dhe më konkretisht nga luhatjet eventuale në angazhimin e tyre në Ballkan. Duhet të themi se realizimi i procesit të eurointegritimit në mënyrë mekanike, pa i zgjidhur paraprakisht konfliktet me prapavija etnike dhe historike ndërmjet shteteve ballkanike, do të sjellë konflikte brenda strukturave euroatlantike dhe do të minojë stabilitetin e Ballkanit dhe të vetë Evropës në të ardhmen.

Agresioni rus krijon pasoja të drejtpërdrejta për Bullgarinë dhe krijon shumë sfida, por edhe mundësi para shtetit tonë. Me rëndësi të veçantë janë pasojat humanitare dhe demografike nga lufta, sepse mbi 300 000 bullgarë jetojnë në viset jugore të Ukrainës. Dhjetëra mijëra prej tyre së bashku me shumë ukrainas, rusë, kaukazë etj. kërkojnë shpëtim në Bullgari. Institucionet bullgare, ndihmuar nga mijëra vullnetarë krijojnë kushtet e nevojshme për strehimin e tyre të përhershëm në Bullgari - bëhen ndryshime në aktet normative, shpërndahen mjete të shumta financiare etj. Biznesi bullgar p.sh. është gati të krijojë 200 000 vende pune për ta, që të mund të rregullojnë jetë e tyre. Nga ana tjetër, po rritet edhe rëndësia ekonomike e Bullgarisë, sepse vendi ynë është prodhues kyç i mallrave

strategjike si gruri (eksportuesi numër dhjetë në botë), luledielli (prodhuesi i shtatë në botë) dhe të produkteve të tjera ushqimore, si edhe i energjisë elektrike në rajonin e Ballkanit (Bullgaria është eksportuesi më i madh në Ballkan). Edhe pse vend i vogël, Bullgaria e ka peshën e vet edhe në tregun botëror të disa produkteve strategjike dhe në disa segmente kryesore - bakër, produkte kimike, elektronikë, armë dhe municione. Në një kohë lufte, kur Bullgaria zë një pozicion kaq të rëndësishëm për Ballkanin dhe për bllokun euroatlantik, çdo sjellje jokorrekte ndaj Bullgarisë, ndaj bullgarëve jashtë Atdheut, duhet të trajtohet si pjesë nga lufta hibride ruse kundër nesh.

**“Epoka e re”:** Si e vlerësoni situatën politike në Kosovë pasi rrethanat këtu i njihni mjaft mirë? Çfarë mendoni ju?

**Pançev:** Kosovës i nevojitet stabilitet politik në muajt në vijim duke marrë parasysh zhvillimet e turbullta gjeopolitike në nivel botëror. Para Kosovës ka sfida të mëdha ekonomike - mungesa të energjisë elektrike, niveli i lartë i importit të ushqimeve etj. Institucionet e Kosovës duhet të kërkojnë angazhim të shpjeg nga Bashkimi Evropian për tejkalimin e këtyre mungesave. Bashkimi Evropian duhet të veprojë me vendosmëri jo vetëm me ndalimin e çdo përpjekjeje serbe për

**Intervistoi:**  
**Arsim SINANI**

**“Epoka e re”:** I dashur prof. Pançev, ju jeni njohës i mirë i proceseve rajonale. Mund të fillojmë me analizën tuaj për proceset politike në rajon e me theks të veçantë ndikimin rus pas fillimit të luftës në Ukrainë. Si i shihni ju nga këndvështrimi juaj këto zhvillime?

**Pançev:** Nuk mund të ketë asnjë dyshim se Ballkani është rajon i rëndësishëm për Federatën Ruse dhe ajo do t'i përdorë të gjitha instrumentet e saj që ta zgjerojë ndikimin në rajonin tonë ose së paku që t'i bllokojë/t'i pengojë

nismat euroatlantike. Lufta në Ukrainë do t'i përshkallëzojë përpjekjet ruse për krijimin e problemeve të bllokut euroatlantik në një rajon me shumë probleme nga karakter i ndryshëm. Vendet e Evropës Juglindore dhe sidomos Rumania dhe Bullgaria u bënë edhe më të rëndësishme nga aspekti i sigurisë, sepse kanë shtete kyçe për mbështetjen ndaj Ukrainës dhe për bllokimin e agresionit rus në Detin e Zi. Këto dy shtete luajnë rolin e “mburojës” për Evropën Juglindore dhe duhet të marrin mbështetjen e nevojshme nga Bashkimi Evropian, nga NATO-ja, por edhe nga shtetet e tjera në Ballkan. Rusia ka pozicione të rëndësishme në sektorin

energjetik në Ballkan (edhe në tërë Evropën) dhe do të duhen vitet dhe shumë mundime, që roli i Moskës të zvogëlohet në një mënyrë që të mos varemi prej saj. Siç shihet nga të lartpërmendurat, Rusia nuk ka shumë instrumente për ndikim në Ballkan në përgjithësi në krahasim me Perëndimin. Moska ka dy vegla më me rëndësi - furnizimi me energji dhe me arma, me të cilat mund t'i mbrojë pozitën e saj në rajon dhe të ndikojë mbi politikën e shteteve ballkanike. Ka edhe dy instrumente të tjera - ndërhyrjet diplomatike dhe ideologjike, duke i përdorur forcat ultranacionaliste dhe antiperëndimore në disa shtete të rajonit, por efektiviteti i tyre varet



destabilizimin e Kosovës, por edhe për garantimin e stabilitetit ekonomik të vendit.

**“Epoka ere”:** Një sfidë tepër e madhe për Republikën e Kosovës janë negociatat me Serbinë. Si i shihni ju këto rrethana tani? Çfarë mendoni se do të ndodhë?

**Pançev:** Negociatat duhet të përshtetohen dhe të përfundojnë me njohjen e shtetit të Kosovës në kufijtë e saj, duke e mbrojtur plotësisht integritetin territorial dhe sovranitetin e Kosovës. Mendoj se është koha e nevojshme që Serbisë t'i vihet kusht të qartë nga ndërmjetësuesit ndërkombëtarë që ta njohë Kosovën, por së pari edhe pesë shtetet e BE-së duhet ta ndërmarrin këtë hap. Nuk mund të ketë më shumë luhate në këtë drejtim, sepse me politikën e deritanishme këtë pesë shtete rrezikojnë stabilitetin e Kosovës dhe rrugëtimin euroatlantik të rajonit.

**“Epoka e re”:** Si i shihni marrëdhëniet në mes të Kosovës dhe Bullgarisë? Si mendoni se duhet të zhvillohen këto marrëdhënie mes nesh?

**Pançev:** Duke i analizuar marrëdhëniet bullgaro-shqiptare një vend të veçantë meriton përkrahja bullgare për ngritjen e Kosovës si shtet. Që pas fillimit të operacionit ushtarak në vitin 1999, institucionet bullgare kanë marrë vendim që ta përkrahnin përmes sigurimit të mbështetjes logjistike për NATO-n. Në etapën e ardhshme, pas luftës, Bullgaria e ka mbështetur operacionin paqeruajtës në Kosovë dhe në vazhdim të politikës së saj parimore në lidhje me çështjen e Kosovës, Bullgaria e ka njohur pavarësinë e Republikës së Kosovës, si dhe vazhdon mbështetjen e saj për shtetin e ri, duke i përdorur resurset e saj politike dhe diplomatike për këtë qëllim. Mendoj se edhe Republika e Kosovës duhet të bëjë përpjekje të vazhdueshme për kuptimin e politikës bullgare kundrejt Ballkanit Perëndimor dhe në veçanti kundrejt Serbisë, sepse politika shoviniste e Beogradit përbën rrezik të përbashkët për ne dhe duhet të gjejmë zgjidhje të përbashkëta. Duhet ta përfundojmë bashkëpunimin ekonomik dhe kulturor që t'i përafrojmë edhe më shumë vendet tona.

**“Epoka e re”:** Serbia është shumë aktive në Ballkan - nisma “Ballkani i hapur”, pretendimet ndaj Bosnjës dhe ndaj Malit të Zi, lojë për ta mbajtur Kosovën jostabile. Cilat janë vlerësimet tuaja për politikën serbe në rajonin e Ballkanit?

**Pançev:** Duhet të pranojmë se Serbia ka një politikë shumë aktive në rajonin tonë që shpesh nuk korrespondon me resurset serbe, por flet për potencialin institucional të këtij shteti. Pas rënies së Millosheviqit Serbia nuk u demokratizua në mënyrë të thellë dhe qarqet shoviniste po vazhdojnë të qeverisin në Beograd duke ëndërruar rimëkëmbjen e Serbisë së Madhe. Për fat të keq, nuk shoh mundësi reale që Serbia të demokratizohet me përpjekje të brendshme të shoqërisë së saj civile, sepse ideologjitë nacionaliste kanë rënë të thella te një pjesë e madhe e popullsisë serbe. Në muajt dhe në

vitet në vijim politika serbe në rajon do të varet drejtpërdrejt nga sukseset ruse në degradimin e rendit evropian të sigurisë, por nëse Rusia do të dështojë dhe, në rastin më të mirë për të gjithë, do të fillonin reforma demokratike në këtë fuqi botërore, politika agresive serbe do të pësojë goditje fatale dhe Beogradi duhet t'i pranojë rregullat demokratike.

**“Epoka e re”:** Si e shihni pozicionimin e Serbisë karshi agresionit rus në Ukrainë? Mendoni se Perëndimi do ta tolerojë një Serbi të tillë?

**Pançev:** Serbia vazhdon lojën e dyfishtë që nga ditë në ditë e demaskon edhe më shumë si mbështetësja e vetme e agresionit rus ndër vendet evropiane (pa marrë parasysh Bjellorusinë natyrisht). Tashmë kanë filluar nismat e zyrtarëve të BE-së që do ta detyrojnë Serbinë ta marrë pozicionim të qartë ndaj agresionit të Putinit - le në Beograd të thonë prerazi me kë do të jenë: me forcat destruktive dhe agresive ose me vendet demokratike. Udhëheqësit politikë në Beograd duhet të kuptojnë se vendimet e tyre në këtë krizë të madhe do ta përcaktojnë fatin e Serbisë, madje edhe në dekadat në vijim.

**“Epoka e re”:** Si i shihni marrëdhëniet në mes të Maqedonisë së Veriut dhe Bullgarisë? Çfarë linje do të ndjekë vendi juaj dhe ju si intelektual, sa mendoni se është punuar për rrënimin e identitetit bullgar në Maqedoninë Veriore?

**Pançev:** Ne nuk e mohojmë identitetin e maqedonasve me të gjitha elementet e tij. Natyrisht se këta njerëz mund të kenë komb, kishë, kulturë, identitet (edhe gjuhë maqedonase pas mbulimit të kriterëve të mirëfillta shkencore), mund të kenë çfarë dëshirojnë dhe e kanë këtë të drejtë pavarësisht mënyrës tragjike të formimit të komunitetit të tyre. Pra, secili njeri dhe secili komb e ka të drejtën e vet për identitet. Këtë të drejtë e kanë si të gjithë qytetarët e Maqedonisë së Veriut, kështu edhe të gjithë qytetarët e Bullgarisë. Por nuk mund ta injorojmë faktin se ka edhe shumë njerëz në Republikën e Maqedonisë së Veriut që nuk pajtohen me mënyrën si po ngrihet një identitet i tillë, që u imponua pas Luftës së Dytë Botërore dhe që po ndërtohet me falsifikime të skajshme, me të cilin sulmohet rëndë identiteti bullgar, sepse shumë figura, ngjarje, procese, artefakte nga këto troje janë pjesë të pandashme nga historia dhe kultura bullgare më shumë se një mijë vjet. Republika e Maqedonisë së Veriut nuk mund të hyjë në BE në gjendjen e saj të tanishme - është një shtet i pareformuar që ndërton identitet mbi bazën e urrejtjes etnike dhe racore kundrejt bullgarëve dhe shqiptarëve. (Ju lutem, shfletoni vetëm një libër mësimor nga ky shtet, ku përshkruhen këta dy popuj), që shkatërron qindra monumente bullgare nga Mesjeta dhe Rilindja, ku gjuha e urrejtjes është shumë e pranishme në hapësirën publike, ku përndjekjet mbi baza etnike janë ndodhi të zakonshme. Nuk mund të hyjë në BE një shtet që nuk i

përbush fare dispozitat e Traktatit me një vend anëtar të BE-së (shihni, p. sh., nenin 8, p. 2 nga Traktati i miqësisë me Bullgarinë, që ka të bëjë me shqyrtimin e historisë të përbashkët), që ka pretendime zyrtare ndaj modelit kushtetues të Bullgarisë, që nuk e ka dënuar regjimin totalitar dhe lavdëron krimet komuniste etj. Për qytetarët e Maqedonisë së Veriut është me rëndësi të ndërtohet një shtet demokratik me të drejta të barabarta për të gjithë qytetarët pa dallime etnike, fetare etj. Hyrja në BE, që për Maqedoninë e Veriut është tepër larg për shkak shumë të tjera, nuk i zgjidh automatikisht këto probleme, sepse edhe Greqia është anëtare e BE-së që 40 vjet, por çështja çame nuk zgjidhet por, të kundërtën, shqiptarët në këtë shtet diskriminohen në mënyrë të ashpër. Prandaj, këto probleme thelbësore në Maqedoninë e Veriut duhet të zgjidhen para anëtarësimit në BE dhe interesi i qytetarëve të saj e kërkon këtë. Mund të përfundojmë se Bullgaria ka dy kërkesa kryesore: 1. Mbrojtja e të drejtave të qytetarëve maqedonas me vetëdije kombëtare bullgare sipas modelit kushtetues të Maqedonisë së Veriut; dhe 2. Përbushja e Traktatit të miqësisë, të fqinjësisë së mirë dhe të bashkëpunimit të nënshkruar më 1 gusht 2017. Këto kërkesa janë në mbrojtje të vlerave evropiane dhe bazohen plotësisht mbi kriteret politike për anëtarësim në BE (Kriteret e Kopenhagenit).

**“Epoka e re”:** Si i vlerësoni marrëdhëniet ndërmjet bullgarëve dhe shqiptarëve gjatë historisë dhe tani? Çfarë mundësi ka për bashkëpunime dhe cilat do të ishin pikat afriese?

**Pançev:** Marrëdhëniet bullgaro-shqiptare janë komplekse dhe përmbajnë elemente të ndryshme. Kurrë nuk duhet të harrohet se projekti serbomadhi në 180 vitet e fundit i ka pasur dhe ende i ka në shënjestër bullgarët dhe shqiptarët. Kjo shihet edhe nga politika jugosllave që përdorte instrumente të njëjta ose të ngjashme për asimilimin e shqiptarëve dhe të bullgarëve në Jugosllavi. Pra, nuk mund të luftosh mekanizmat e politikës serbe, p. sh., në Kosovë, por pa dashje ta ndihmohet këtë projekt në Maqedoninë e Veriut duke e mbështetur politikën e autoriteteve të Shkupit. Kur Republika e Shqipërisë e njohu zyrtarisht pakicën bullgare në vitin 2017, kjo u vlerësua tepër lart në Bullgari, sepse

Shqipëria është shembull në Ballkan për mirësjellje të vazhdueshme ndaj komuniteteve pakicë në territorin e saj. Kjo tregon qartë se Shqipëria dhe populli shqiptar gjithmonë kanë ndjekur standardet më të larta humane ndaj të tjerëve edhe pse kundër shqiptarëve janë kryer gjenocide të tmerrshme gjatë shekullit XX, por edhe sot bëhen përpjekje për fshirjen e shqiptarëve në Luginën e Preshevës. Kjo politikë e shtetit shqiptar ndikoi shumë në zhvillimin e bashkëpunimit tonë dhe duke u bazuar mbi traditat tona të miqësisë është lehtë të bëhet parashikimi se marrëdhëniet ndërmjet Bullgarisë dhe Shqipërisë/Kosovës do ta vazhdojnë trendin pozitiv, por duhet të thellohen edhe më shumë në fushën e ekonomisë dhe në fushën e kulturës. Në mosmarrëveshjet me Greqinë dhe Serbinë, që kanë bazë të fortë historike, do të ishte mirë politikanët shqiptarë ta ndjekin shembullin e Bullgarisë - këto konteste të zgjidhen edhe mbi faktet dhe dokumentet autentike. Sa iu përket marrëdhënieve tona historike, mund të nxirren disa konkluzione kryesore. Politika bullgare ndaj shqiptarëve është e palëkundshme pas vitit 1913 dhe është e qartë - miqësi dhe bashkëpunim me të tërë faktorin politik dhe intelektual shqiptar. Bullgaria dhe udhëheqësit e saj gjithnjë kanë pasur dëshirë dhe kanë punuar për përfundimin dhe për konsolidimin e faktorit politik shqiptar në Ballkan, sepse kjo na konvenon shumë. Qëllimi i gjeopolitikës bullgare në Ballkan gjatë shekullit të fundit është të kemi për aleat një Shqipëri të fortë dhe të unifikuar. Prandaj, Bullgaria gjithnjë ka punuar për konsolidimin e faktorit shqiptar, krejt ndryshe nga Serbia dhe Greqia, por në dekadat e fundit edhe Maqedonia e Veriut, që gjithmonë kanë kërkuar ta përçajnë dhe ta dobësojnë faktorin shqiptar që t'i realizojnë planet e tyre gjeopolitike, duke u “pajtuar” me qarqe të papërgjegjshme në politikën shqiptare.

**“Epoka e re”:** A mund të paraqitni ide dhe plane konkrete për zhvillimin e bashkëpunimit në fushën e shkencës, kulturës dhe të politikës?

**Pançev:** Arkivat e Bullgarisë kanë mijëra dhe mijëra dokumente që janë shumë të rëndësishme për historinë shqiptare dhe japin dëshmi të vlefshme për proceset e shqiptarët gjatë kohës. Ka shumë dokumente që flasin për karakterin

etnik shqiptar të Kosovës. P.sh., është folur shumë dhe duhet të flitet edhe më shumë për diasporën shqiptare në Bullgari gjatë kohës së Perandorisë Osmane, për katundin e Mandricës, për koloninë shqiptare në Sofje dhe në qytete të tjera që kanë dhënë kontribut të jashtëzakonshëm për zhvillimet e proceseve të ndryshme në epokën e Rilindjes Shqiptare. Në vitet e fundit unë personalisht merrem me hulumtime për ndikimin e shqipes mbi disa dukuri gjuhësore në të folmet dhe në dialektet bullgare. Dalin fakte tepër interesante që tregojnë se konvergjenca ndërmjet bullgarishtes dhe shqipes ka qenë edhe më e thellë sesa kemi menduar.

**“Epoka e re”:** Nuk të qëndroj pa ju pyetur për bashkëjetesën e shqipes dhe bullgarishtes në Mandricë. Çfarë mendimi keni ju?

**Pançev:** Në të vërtetë janë mbledhur materiale të shumta për të folmen e Mandricës, të cilat ende japin hapësirë dhe janë bazë të qëndrueshme për studime të mëtejshme, por është e nevojshme të mblidhen edhe materiale të reja, sepse në dekadat e fundit nuk është bërë ndonjë hulumtim i gjithanshëm.

Hulumtimet e reja më së shumti duhet të bëhen në fushën e sociolinguistikës, që të ndiqen ndryshimet leksikore, morfologjike dhe sintaksore në këtë të folme shqiptare. Në vitet e fundit, falë punës së studiuesve bullgarë dhe të huaj, hulumtohen edhe aspekte të tjera të jetës së banorëve të katundit, si folklori, veshjet etj. Studimet në të ardhmen duhet të përqendrohen mbi sintaksën, frazeologjinë dhe interferencat midis gjuhëve. Gjithashtu, duhet ta përmendim edhe faktin se në masë të madhe janë anashkaluar hulumtimet në fushën e toponimisë dhe në lëndët e tjera gjuhësore, përmes të cilave mund të jepet një kontribut i rëndësishëm për historinë e shqipes në Bullgari.

Pa dyshim, hulumtimet mbi të folmen e Mandricës dhe mbi të gjuhën e rilindësve shqiptarë dhe veprat e tyre publikuara në Bullgari, kanë një potencial të madh dhe këto mundësi duhet të shfrytëzohen sa më shpejt që te jetë e mundshme, sidomos për Mandricën, ku situata demografike, si dhe në pothuajse të gjitha katundet e Bullgarisë, është kritike. Ju faleminderit shumë!





## Në Kamenicë mbahet trajnim për krasitjen dimërore

KAMENICË, 17 MARS (ER) - Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në Kamenicë ka mbajtur

trajnimin në terren për krasitjen dimërore. Ky trajnim ka filluar në fshatin Karaçevë, ka përfunduar në

Roganë. Përgjatë këtij trajnimi është sqaruar mënyra e krasitjes për vreshtarë nga këto fshatra.

Këshillimet e trajnimit nëpër fusha të ndryshme, specifikisht në atë të bujqësisë, do të shtohen.



## Komuna e Gjilanit dhe policia bashkëveprojnë për parandalimin e prerësve ilegalë të pyjeve

GJILAN, 17 MARS (ER) - Drejtori i Bujqësisë dhe Pylltarisë në Gjilan, Bajram Isufi, së bashku me udhëheqësin e sektorit të Pylltarisë, Kujtim Shahiqi, janë takuar me komandantin e Stacionit të Policisë, Agim Lipovica, në kuadër të vazhdimit të bashkëpunimit reciprok për parandalimin e keqpërdoruesve, përkatësisht prerësve ilegalë të pyjeve.

Në takim janë marrë vesh që të hartohen plane të përbashkëta të cilat do të kenë cak bartësit ilegalë të pyjeve, prerësit ilegalë dhe shitësit ilegalë. "Pyjet janë pasuri nacionale dhe, si të tilla, duhet kujdesur për to, duhet të merren të gjitha masat rreth parandalimit të prerësve ilegalë të pyjeve tona. Pa një bashkëpunim të mirë me institucionet relevante, siç është policia shtetit, do të ishte e pamundur të kemi rezultate pozitive", ka thënë drejtori Isufi.

Komandanti i Stacionit të Policisë, Agim Lipovica, ka shprehur gatishmëri të ofrojë çdo



lloj asistence që nevojitet për sektorin e pylltarisë me qëllim të parandalimit dhe ndalimit të prerjes ilegale të pyjeve. "Do të

përpiqemi që në çdo mënyrë të parandalojmë këtë dukuri dhe fenomen negativ", ka thënë Lipovica.

Nga viti 2010, sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (nr. 03/L-040), komunat kanë edhe kompetenca të deleguara nga ana

e Agjencisë e të cilat ndërlidhen me mbrojtjen e pyjeve dhe lëshimin e lejeve për prerjen e pyjeve publike dhe private.



## Dedaj dhe Bislimi u priten në parlamentin e Zvicrës në Bern

BERN, 17 MARS (ER) - Ish-ambasadori i Kosovës në Maqedoninë e Veriut, Gjergj Dedaj, dhe drejtori i organizatës joqeveritare "Zëri Perëndimor i Kosovës", Sali Bislimi, kanë takuar në parlamentin e Zvicrës në Bern deputeten Doris Fiala. "Ishte nder, i shoqëruar nga bashkëpunëtori dhe veprimtari Sali Bislimi, për ta takuar në Parlamentin e Zvicrës deputeten Doris Fiala. Një zonjë e fuqishme e liberalëve (FDP) të Zvicrës, ish-anëtare e Këshillit të Evropës dhe kryesuese e delegacionit të Zvicrës në Parlamentin Evropian", ka shkruar Dedaj në llogarinë e

vet në "Facebook". Dedaj ka theksuar se me Fialan kanë biseduar për zhvillimet aktuale në Kosovë dhe rajon, për perspektivën evropiane dhe integrimet euroatlantike të Kosovës, për nevojën imediate të respektimit të të drejtave të njeriut, barazisë, demokracisë, sundimit të ligjit dhe lirisë së shprehjes dhe pavarësisë së medieve në Kosovë. "Njëkohësisht temë e bisedës në këtë takim ishte edhe falënderimi dhe mirënjohja ndaj shtetit mik të Zvicrës për trajtimin dhe integrimin në institucionet dhe shoqërinë zvicerane të mërgatës së Kosovës në Zvicër", ka shkruar ish-ambasadori Dedaj.

## Bulliqi dhe Aliu diskutojnë për sfidat dhe vështirësitë në qeverisjen lokale

PODUJEVË, 17 MARS (ER) - Kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka pritur në takim kryetarin e Shtëmës, Qemal Aliu, me të cilin ka folur për sfidat dhe

vështirësitë në qeverisjen lokale. Gjithashtu, ai ka treguar se kanë diskutuar edhe për projektet e ndryshme. "Prezantova edhe disa prej synimeve që kemi gjatë këtij viti

dhe viteve vijuese për realizimin e projekteve madhore që nxitin zhvillimin ekonomik lokal dhe përmirësojnë jetën e qytetarëve llapjanë. Me kryetarin Aliu

potenciam përkushtimin tonë të plotë për bashkëpunim ndërkomunal me qëllim të realizimit të projekteve në interes të përgjithshëm", ka bërë me dije Bulliqi.





# KMDLNj: Mosvotimi i Kodit Civil, lojë politike e pozitës dhe opozitës

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 17 MARS - Në seancën e së mërkurës, më 16 mars, të Kuvendit të Kosovës, ka dështuar votimi i Kodit Civil shkaku se prej 61 deputetëve sa kishin votuar, 28 deputetë kishin votuar për, 29 kishin votuar kundër, ndërsa katër të tjerë kishin abstenuar.

Sipas Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj), duket qartazi se Kodi Civil nuk ishte votuar për faktin se shumë deputetë janë frikësuar se me këtë Kod Civil i hapet rruga legalizimit të martesave të gjinisë së njëjtë e që e kanë bërë me dije edhe në diskutimet e tyre para se të votohej ky ligj. "Disa prej tyre deklaruan se do të votojnë për këtë Kod Civil nëse hiqet neni përkatës që e lë këtë mundësi dhe për të cilin kanë kërkuar që të votohen pa asnjë ndryshim vendet e Quintit dhe të BE-së. Për KMDLNj-në është e padiskutueshme e drejta e deputetit që të votojë pa iu nënshtruar asnjë presioni dhe të votojë në bazë të vullnetit të deputetit duke përfaqësuar dhe mbrojtur të drejtat e votuesve që e kanë votuar, por edhe votuesve të tjerë, të drejtat e qytetarit të Kosovës, pavarësisht prej përkatësisë etnike, bindjeve politike, besimeve fetare, moshës, gjinisë apo statusit në shoqëri e që në shumë raste nuk ka ndodhur për faktin se deputetët i janë nënshtruar presionit brutal të subjektit që i takon dhe bashkësisë ndërkombëtare siç ishte rasti me demarkacionin apo themelimin e Gjykatës Speciale", është thënë në reagimin e KMDLNj-së.



KMDLNj në këtë reagim ka theksuar se është e shqetësuar për fjalorin e papërmblitur, degradues, fyes dhe përjashtues që deputetët e Kuvendit të

Kosovës e përdorin kryesisht në mungesë të fakteve dhe për qëllime politike. "Me rastin e diskutimeve për Kodin Civil në Kuvendin e Kosovës pati

diskutime të papranueshme nga aspekti i të drejtave të njeriut dhe nga aspekti i mandatit të deputetit me ç'rast u fyer rëndë pjesëtarët e një komunitetit me orientim seksual ndryshe e që nuk do të duhej të tolerohej sikur që deputetët e tillë do të duhej të sanksionoheshin për këtë fjalor përjashtues, fyes, degradues, diskriminues dhe racist. E drejta e pakundërshtueshme dhe e pamohueshme e deputetit që të votojë në bazë të bindjeve që i ka, vullnetit dhe pa iu nënshtruar asnjë presioni, nuk nënkupton edhe të drejtën që të fyejë dhe t'i diskriminojë të tjerët edhe nëse nuk pajtohen me asgjë me përmbajtjen e ligjit të propozuar",

është theksuar në këtë reagim. Mosvotimin e Kodit Civil KMDLNj-ja e konsideron më shumë si lojë politike, të pozitës dhe opozitës. "Pa asnjë dyshim ky Kod Civil do të votohet në një të ardhme të afërt, prandaj deputetët e Kuvendit të Kosovës duhet të tregohen shumë të kujdesshëm dhe të përmblitur për fjalorin që e përdorin. KMDLNj e respekton, si të drejtë të njeriut, edhe mospajtimin e disa deputetëve me këtë Kod Civil, mirëpo nuk përkrah në asnjë mënyrë fjalorin fyes, diskriminues dhe degradues ndaj askujt, në rastin konkret, të komunitetit me orientim seksual ndryshe", është theksuar në reagimin e KMDLNj-së.

## Deliu-Kodra: E papranueshme heshtja e Osmanit për dështimin e miratimit të Kodit Civil

Deputetja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Blerta Deliu-Kodra, ka thënë se është e papranueshme heshtja e presidentes Vjosa Osmani për dështimin e miratimit të Kodit Civil, i cili, sipas saj, përveç të tjerash, parashihet edhe rregullimin e të drejtës së grave në trashëgimi. "Qeveria e arrogancës së numrave dështoi t'i sigurojë votat në radhët e veta për ta miratuar Kodin Civil, i cili, përveç të tjerash, parashihet edhe rregullimin e të drejtës së grave në trashëgimi. Ne si parti e kemi arsyetuar qëndrimin tonë në Kuvend, përderisa pozita me shumicën parlamentare mbiveton çdo iniciativë tonë ligjore e amandamentuese duke demonstruar arrogancë në vend të veprimeve të arsyeshme në të mirën e përgjithshme", ka shkruar Deliu-Kodra në "Facebook".

Ajo ka theksuar se është e papranueshme heshtja e presidentes Vjosa Osmani për dështimin e miratimit të Kodit Civil. "Mungesa e guximit minimal për t'u deklaruar për çështjet që kërkojnë përfshirjen e saj si përfaqësuese e unitetit, gardiane e mbrojtjes së të drejtave njerëzore e, mbi të gjitha, si një grua - në rastin konkret të dështimit të miratimit të Kodit Civil, i cili afekton të drejtën e trashëgimisë për gratë", ka thënë Deliu-Kodra, duke shtuar se Osmani është duke ridëshmuar për të satën herë radhazi se i mungon aftësia për të udhëhequr, së pari nga parimet humane e mandej politike. "Pozita që mban nuk e toleron kalkulimin personal mbi interesin e përgjithshëm. Përndryshe, ky cilësohet abuzim me pozitën dhe ushtrimin e detyrës", ka theksuar Deliu-Kodra.



## Ministri i Shëndetësisë: Covid-19 është i pranishëm dhe nuk ka kaluar

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 17 MARS - Ministri i Shëndetësisë, Rifat Latifi, ka folur të enjten për procesin e vaksinimit kundër Covid-19. Ai ka thënë se angazhimi i komunave në këtë aspekt do të ketë efekt më të madh për përmirësimin e këtij procesi sepse, siç ka thënë ai, "Covid-19 është i pranishëm dhe nuk ka kaluar".

Në takim me drejtorët e Drejtorive Komunale të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, të organizuar nga Kolegjiumi i Drejtorëve të Shëndetësisë së Komunave, ku temë diskutimi ishte situata në sektorin e shëndetësisë në komuna, Latifi ka theksuar rëndësinë e Kujdesit Parësor



Shëndetësor dhe bashkëpunimin dhe ndërlidhjen midis nivelit qendror dhe lokal. Ai ka thënë se në Ministrinë e Shëndetësisë po punohet në shtatë shtylla, të cilat, sipas tij, kanë të bëjnë me transformimin e sektorit të

shëndetësisë, me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimeve shëndetësore dhe i cili sistem ka në qendër të vëmendjes pacientin. Duke përmendur rëndësinë e ligjeve të cilat janë në procedura të

hartimit dhe shqyrtimit, ministri Latifi ka thënë se në këtë aspekt është duke u punuar fuqishëm që të përmbushet agjenda legjislative dhe të bëhet edhe Ligji për Transplantim të Organeve. Theks të veçantë, ministri Latifi vuri edhe te funksionimi i telemjekësisë në nivelin lokal. Sipas tij, ky shërbim ka hyrë në funksion që nga viti 2002, ndërsa është e nevojshme të shtrihet në të gjitha qendrat rajonale shëndetësore të vendit. Ndërkaq drejtorët e Drejtorive Komunale të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale u zotuan për bashkëpunim me nivelin qendror, duke përmendur edhe sfidat dhe problemet me të cilat ata po ballafaqohen, përfshirë edhe resurset humane të kufizuara.

Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit, nga 1 126 testime, 33 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes. Të enjten janë shënuar edhe 23 qytetarë, ndërsa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 223 230. Në total numri i rasteve aktive me Covid është 644. Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit janë dhënë 313 doza të vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 818 721 doza të vaksinës. Deri më sot 818 890 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë. Po ashtu, deri më sot janë dhënë 98 881 doza përforcuese dhe doza të treta të vaksinës kundër Covid-19.



# Kurti thotë se qeveria mbetet e përkushtuar për hartimin dhe zbatimin e politikave sociale

**EPOKA E RE** **Albulena S. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 17 MARS** - "Puna sociale përbën përpjekje të vazhdueshme për t'i përmbushur nevojat bazike të qytetarëve, për ta rritur përgjegjësinë kolektive e për ta ngritur mirëqenien qytetare. Këto themele të punës sociale materializohen përmes shërbimeve e politikave sociale, që kontribuojnë në eliminimin e rreziqeve, të cilat u kanosen grupeve të cënueshme, pastaj kontribuojnë në zvogëlimin e varfërisë, në mbrojtjen nga diskriminimi e keqtrajtimi e të tjera", ka thënë kryeministri Albin Kurti në konferencën nacionale në shënim të Ditës Botërore të Punës Sociale. Ai ka theksuar se qeveria, krahas politikave zhvillimore, në programin e saj ka prioritet mbrojtjen sociale për qytetarët me programet adekuate të qëndrueshme, pra afatgjata.

Kryeministri Kurti ka thënë se që nga fillimi i këtij mandati janë ndërmarrë një sërë masash që ndihmojnë drejtpërdrejt grupet e cënueshme të shoqërisë, duke

filluar nga rritja e shumës së asistencës sociale, rritja e pensioneve e fillimi i zbatimit të programit për shtesa për lehonë e shtesa për fëmijë. Ai ka thënë se si rezultat i këtyre masave kanë përfituar rreth 26 mijë familje në asistencë sociale, mbi 300 mijë pensionistë, 12 mijë lehonë dhe mbi 140 mijë fëmijë. Kurti ka shtuar se në kuadër të Qendrave për Punë Sociale ka vazhduar ofrimi i shërbimeve, si: mbrojtja dhe trajtimi i viktimave të dhunës në familje, viktimave të trafikimit, fëmijëve me nevoja të veçanta; këshillimi psiko-social, vetëdijësues e edukativ për fëmijë; si dhe strehimi i fëmijëve të keqtrajtuar, viktimave të dhunës në familje dhe viktimave të trafikimit. "Kështu, janë ofruar rreth 12 mijë shërbime sociale nga Qendrat për Punë Sociale, kurse nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve janë licencuar rreth 48 organizata joqeveritare për ofrimin e këtyre shërbimeve. Si qeveri mbesim të përkushtuar për hartimin dhe zbatimin e politikave sociale që në fokus e kanë qytetarin dhe barazinë shoqërore", ka theksuar kryeministri Kurti.



Ai ka bërë me dije se qeveria veçse ka filluar procesin e reformimit të skemës së asistencës sociale, e cila ka për qëllim eliminimin e kriterëve diskriminues për përfitim nga skema, dhe rritjen e mbulueshmërisë përmes implementimit të testit të ri të

varfërisë. Duke synuar rritjen e cilësisë së ofrimit të shërbimeve sociale dhe ngritjen e kapaciteteve njerëzore në këtë fushë, Kurti ka thënë se qeveria ka filluar zbatimin e programit të praktikës në punë për studentë të shkencave shoqërore të Universitetit të

Prishtinës. Kryeministri ka thënë se programet e tilla të angazhimit të profesionistëve të rinj socialë do të vazhdojnë të zbatohen dhe të zgjerohen edhe më tutje përmes programit të Skemës së Garantimit të Punësimit për të Rinj, e cila do të fillojë e të zbatohet shumë shpejt.

## Përkrahen financiarisht studentët e komunitetit ashkali, egjiptian dhe rom

**PRISHTINË, 17 MARS (ER)** - Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, dhe ministrja e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit, Arbërie Nagavci, kanë nënshkruar memorandumin e bashkëpunimit për ofrimin e mbështetjes financiare për studentët e komunitetit ashkali, egjiptian dhe rom të cilët studiojnë në universitetet publike në Kosovë.

Qëllimi i këtij memorandumit është promovimi i edukimit të këto komunitete, nxitja në zhvillim akademik, krijimi i mundësive që studentët të mos i ndërpresin studimet për shkak të kushteve të vështira materiale, si dhe krijimi i brezave të rinj të mësimdhënësve dhe ligjëruesve nga radhët e komuniteteve. Me



këtë rast, ministri Krasniqi ka theksuar se kjo përkrahje

financiare do të ndikojë në rritjen e nivelit arsimor të këtyre

komuniteteve, ndërsa ka thënë se për informim rreth kësaj

mundësie duhet të punohet bashkë me shoqërinë civile, shkollat dhe komunat.

Ndërkaq ministrja e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit, Arbërie Nagavci, pasi që ka theksuar rëndësinë e mbështetjes financiare për studentët e këtyre komuniteteve, përmendi edhe mbështetjen që po jep ministria për qendrat mësimore me bazë në shkollë dhe me bazë në komunitet, si dhe bursat që ndahen për nxënësit e shkollave të mesme për komunitetin ashkali, egjiptian dhe rom.

Ministri Krasniqi dhe Nagavci u zotuan se si institucione do të punojnë vazhdueshëm për krijimin e mundësive të barabarta në arsim për të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë.

## Kërkohet paraburgim ndaj dy të dyshuarve në rastin "Brezovica"

**PRISHTINË, 17 MARS (ER)** - Prokuroria Themelore në Ferizaj, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka kërkuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj caktimin e masës së paraburgimit në kohëzgjatje prej 30-ditësh ndaj të pandehurve N. G. dhe S. I., të cilët me vendim të Prokurorit të Shtetit gjenden nën masën e ndalimit 48 orësh. Sipas

kërkesës së Prokurorisë, ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri N. G., zyrtar doganor, prej vitit 2014, në Shtërpcë, ka ndihmuar personin zyrtar gjatë kryerjes së veprës penale "Marrja e ryshfetit", me këtë do ta kryente veprën penale "Marrja e ryshfetit" në ndihmë nga neni 428, par. 2, lidhur me nenin 33 të KPRK-së. Edhe për të pandehurin S. I.,

ish-zyrtar i komunës Shtërpcë, tani menaxher në Qendrën e Skijimit në Brezovicë, ekziston dyshimi i bazuar se nga viti 2010, në Shtërpcë, ka ndihmuar personin zyrtar për kryerjen e veprës penale "Marrja e ryshfetit", me këtë do të kryente veprën penale "Marrja e ryshfetit" në ndihmë nga neni 428, par. 2, lidhur me nenin 33 të KPRK-së.





# Kristofor Kolombi, dritë-hijet e eksploruesit që u garantoi evropianëve dominimin e botës



Shumica e njerëzve e njohin emrin e Kristofor Kolombit. Ai është një nga eksploruesit më të famshëm të historisë, edhe pse arritjet dhe trashëgimia e tij janë sot shumë të diskutueshme. Kolombi mund të mos e ketë zbuluar Amerikën, por ai ndërmori disa udhëtime në këtë kontinent, të cilat ndihmuan në fillimin e Epokës së Eksplorimeve. Teksa lavdërohet për arritjet e tij, ai kritikohet për keqtrajtimin e popullatave indigjene dhe madje edhe të ekuipazhit të tij. Ja çfarë mund të mos dini mbi jetën e ndërlikuar të Kristofor Kolombit.

## Shumica e historianëve, besojnë se ai lindi në Xhenova të Italisë

Konsensusi i shumicës së historianëve është se Kristofor Kolombi lindi në Republikën e Gjenovës (ose Xhenovës), në atë që më vonë do të bëhej Italia. Data e saktë e lindjes së tij nuk dihet, por vlerësohet se ai ka lindur diku në vitin 1451. Ka të ngjarë që nëna e tij ishte Suzana Fontanarozza, dhe babai i tij ishte një tregtar i leshit i quajtur Domeniko Kolombo.

## Por ekziston edhe teoria, sipas së cilës Kolombi ishte nga Portugalia

Italianët kanë pretenduar prej kohësh se Kristofor Kolombi ishte

njëri prej tyre. Por jo të gjithë janë dakord mbi vendlindjen e eksploruesit të famshëm. Në vitin 2012, profesori i Universitetit të Lisbonës, Fernando Branko, botoi një libër që pretendon se Kolombi ka lindur në fakt në Portugali.

Sipas kësaj teorie, Kolombi ishte në fakt një njeri i quajtur Pedro Ataide, dhe emri Kolombi ishte një maskim. Pedro Ataide dyshohet se vdiq gjatë një beteje detare në vitin 1476. Por Branko pretendohet se ai mbijetoi, dhe zbarkoi në brigjet Algarve në Portugalinë Jugore.

Një nga të dhënat e para historike të Kolombit, e përshkruan atë duke notuar larg një anijeje që po mbytej. Pjesa më e madhe e provave që paraqet Branko, mund të konsiderohen si rastësore. Por teoria e tij, nënvizon faktin se sa shumë detaje mungojnë në të dhënat historike të jetës së hershme të Kolombit.

## Udhëtimi i Kolombit drejt Amerikës nisi nga Spanja, dhe jo Italia

Për ta bërë edhe më konfuze çështjen e përkatësisë së tij etnike, Kolombi nuk e kreu udhëtimin e tij të famshëm nën flamujt e Italisë apo Portugalisë. Në fundin e shekullit XV, ai hartoi një plan për të gjetur një kalim të ri drejt Indive Lindore, duke lundruar këtë herë nga Perëndimi.

Nëse udhëtimi i tij do të ishte i

suksesshëm, fitimet që do të arkëtonte nga një rrugë alternative e tregtimit të erëzave, mund ta bënin atë të pasur. Por fillimisht ai kishte nevojë për fonde për të nisur ekspeditën e parë.

Mbretëresha Izabela I e Kastiljes dhe Mbreti Ferdinand II i Aragonës, ranë më në fund ranë dakord që ta sponsorizonin udhëtimin e tij. Kështu në gushtin e vitit 1492, ai udhëhoqi anijet "Pinta", "Nina" dhe "Santa Maria" në udhëtimin e tyre nga porti i Palos në Spanjë drejt asaj që quhej "Bota e Re".

## Anijet me të cilat lundroi drejt Amerikës ishin një makth për të

Dy anije më të vogla që përbënin flotën e Kristofor Kolombit, "Nina" dhe "Pinta" ishin karavela të teknologjisë së fundit për kohën. Ato ishin të famshme për velat e tyre aerodinamike, ishin më të lehta në peshë, dhe për pasojë më të shpejta në lundrim.

Por nga ana tjetër ishin shumë jo komode për marinarët. E vetmja kabinë që ndodhej në pjesën e prapme të anijes, ishte e rezervuar për kapitenin e saj. Pjesa tjetër e 20 deri në 30 anëtarëve të ekuipazhit, ishin të detyruar të flinin në kuvertën e ngushtë.

Situata ishte pak më e mirë në bordin e anijes "Santa Maria", e cila ishte më e madhe, dhe ku kishte kabina si për Kolombin ashtu edhe

për ekuipazhin e tij. Gjithsesi marinarët ishin në prag të rebelimit në kohën kur flota e tij, arriti në ishullin e Bahamasit pas afro 2 muajsh lundrim në det.

## Nuk ishte i pari evropian i parë që zbuloi Amerikën e Veriut

Për shekuj me radhë, Kolombi është cilësuar gabimisht si zbuluesi i Amerikës së Veriut, një kontinent ku qytetërimi njerëzor kishte lulëzuar tashmë prej mijëra vjetësh. Por edhe titulli i evropianit të parë, që udhëtoi në kontinentin amerikan, është i pasaktë. Eksploruesi viking Leif Erikson e mund Kolombin në këtë aspekt me gati rreth 500 vite mëherët. Besohet se ai zbarkoi në Njufaulnd të Kanadasë rreth vitit 1000. Ndërkohë legjendat sugjerojnë madje se murgjit irlandezë udhëtuan në Kanada nga Deti i Veriut përpara udhëtimin të Eriksonit apo Kolombit.

## Udhëtimi i tij në vitin 1492, nuk ishte vetmi në Amerikën e Veriut

Pas kontaktit të tij fillestar me Amerikën në vitin 1492, Kolombi u rikthye disa herë atje. Ai u kthye në Spanjë për më pak sesa 1 vit. Ndërkohë në shtatorin e vitit 1493 kaloi Atlantikun për herë të dytë.

Pastaj kaluan 5 vite para se të niste udhëtimi i tij i tretë në Amerikën e Veriut në vitin 1498, kur ai u arrestua me akuzën e keqtrajtimit të banorëve vendas.

Udhëtimi i tij i katërt dhe i fundit në Karaibe ndodhi në vitin 1502. Kolombi nuk e zbuloi asnjëherë Kinën apo Indinë apo arin që kërkonte, por ia doli të terrorizonte dhe të skllavëronte banorët vendas të ishujve atje. Kolombi vdiq 20 maj 1506.

Dita e Kolombit u bë një festë kombëtare në SHBA në vitin 1937, por jo të gjithë janë adhures të eksploruesit të famshëm

Në vitin 1937, presidenti amerikan Frenklin Ruzvelt e shpalli 12 tetorin si Ditën e Kolombit, dhe kjo falë ndikimit të një grupi katolik të quajtur "Kalorësit e Kolombit". Në vitin 1971, presidenti Riçard Nikson krijoi versionin modern të Ditës së Kolombit, duke vendosur që ajo të festohej të hënën e dytë të çdo muaji tetor.

Por kjo nuk do të thotë se të gjithë janë adhures të kësaj feste. Për shkak të keqtrajtimit ndaj amerikanëve vendas dhe njerëzve të tjerë indigjenë, shumë shtete dhe qytete në SHBA refuzojnë ta kremtojnë Ditën e Kolombit. Në vend të saj ata zgjedhin Ditën e Popujve Indigjenë, ndërsa të tjerët festojnë Ditën e Leif Erikson për të nderuar eksploratorin e famshëm viking. / bota.al





QENDRA SPORTIVE  
'BUJOËSIA'  
TEL: 045/82 82 82

## Ademi, pas lirim: Debat verbal në FFK u shfrytëzua nga grupet e interesit

Kryetari i FFK-së, Agim Ademi, është liruar nga paraburgimi. Ai ka ripërsëritur edhe një herë se nuk ka pasur sulm, por vetëm debat verbal me Artan Govorin, drejtor për marrëdhënie me jashtë në Federatën e Futbollit. "Pas deklaratave të të gjitha palëve të përfshira, u sqarua se e tëra ishte vetëm një keqkuptim, kështu që unë u lirova nga ndalimi dhe gjendem në mesin e familjarëve dhe kolegëve të FFK-së", ka thënë Ademi



nevrikosje e sipër. Po ashtu, i kërkoj falje publike kujtdo që është lënduar nga unë pasi e kam thënë atë fjalë. Aspak nuk ishte ai qëllimi im, ngaqë nuk përkon me karakterin e as etiken time", ka shkruar Berisha në "Facebook".

Kryetari i "dardanëve" më pas ka folur edhe për gjithë situatën që ka ndodhur në Federatën e Futbollit të Kosovës. Ai e ka mohuar se kryetari Ademi e ka sulmuar Artan Govorin dhe e gjitha ishte trillim nga Govorin. "Tani më duhet të flas për situatën që u mundua të paraqitej në formën që nuk ngjau, duke krijuar insinuata të panevojshme. E vërteta qëndron në atë se (unë me kryetarin e FFK-së, Agim Ademi) ishim duke qëndruar bashkë dhe gjithë ajo çfarë u përpoq t'i shitej publikut, ishte trillim që nuk përkiste me realitetin dhe atë që unë vetë e pashë. Mu për shkak të gënjeshtrave dhe intrigave, u bëra temperament. Ato nuk mund t'i pranoj për të vetmen arsye, sepse veten e konsideroj shqiptar të dinjitetshëm dhe të vërtetë. Unë di për çfarë vlerash qëndroj!", ka shtuar Berisha.

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 17 MARS - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, është liruar të enjten në mesditë nga paraburgimi. Në një shkrim të publikuar në "Facebook" ai ka reaguar menjëherë pas lirim, duke thënë se përfundoi për disa orë në polici për shkak të një debati verbal që kishte me një koleg në Federatën e Futbollit dhe që ai debat u shfrytëzua nga grupet e interesit. "Të mërkurën, për shkak të një debati verbal që pata me një koleg të FFK-së, i cili debat kishte qëllim krejt të mirë, për të sqaruar një situatë nga marrëdhënia e punës në FFK, përfundoi pa shkas në polici dhe iu dha hov nga disa medie dhe

grupe të interesit, duke e shfrytëzuar situatën zgjedhore që kemi në FFK, me ç'rast unë përfundova për disa orë në polici. Pas deklaratave të të gjitha palëve të përfshira, u sqarua se e tëra ishte vetëm një keqkuptim, kështu që unë u lirova nga ndalimi dhe gjendem në mesin e familjarëve dhe kolegëve të FFK-së", ka thënë Ademi, i cili i ka falënderuar të gjithë ata që kanë shprehur interesim dhe mbështetje për të. "Ju falënderoj edhe një herë të gjithë ju bashkëpunëtorëve të mi dhe komunitetin e futbollit për interesimin dhe mbështetjen, njëherësh ju garantoj se do të punoj së bashku me ju për ngritjen e futbollit dhe për avancimin e Federatës së Futbollit të Kosovës", ka shtuar

ai. Në fund kryetari Ademi është zotuar se me stafin e FFK-së do ta vazhdojnë punën për Kuvendin e 6 prillit dhe për ndeshjet miqësore që Përfaqësuesja e Kosovës i zhvillon këtë muaj. "Ju siguroj se së bashku me stafin e FFK-së do ta vazhdojmë punën e madhe që na pret për organizimin e një procesi zgjedhor ligjor dhe të rregullt për datën 6 prill 2022, si dhe për organizimin e ndeshjeve të Kombëtares së Kosovës, kundër Burkina Fasos dhe Zvicrës këtë muaj", ka përfunduar Ademi. Të mërkurën është raportuar se Agim Ademi e ka sulmuar Artan

Govorin, ndërsa ky i fundit e ka raportuar rastin në polici. Arrestimi i Ademit ka ndodhur në mbrëmjen e së mërkurës.

### 'Luli' i 'dardanëve' kërkon falje publike

Kryetari i tifo-grupit "Dardanët", Lulzim Berisha, ka kërkuar falje dhe është distancuar nga fjalimi i tij, pas shprehjeve fyese për komunitetet joshumicë në Kosovë. Berisha gjatë një debati me Artan Govorin iu drejtua me fjalët "ne jemi shqiptarë, nuk jemi maxhupë". "Përmes kësaj shkrese publike dua të distancohem nga termi që kam përdorur dje në afekt dhe në

## Ministri Çeku, FFK-së: Nuk lejojmë shkelje të ligjit e të statutit



PRISHTINË, 17 MARS - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, i ka bërë thirrje Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), ta respektojë statutin e saj dhe Ligjin e Sportit të Republikës së Kosovës në procesin zgjedhor për kryetar të saj. Mandati i kryetarit aktual, Agim Ademi, skadon në muajin korrik, por Komiteti Ekzekutiv i FFK-së, në krye me Agim Ademin, e ka thirrur për 6 prill

Kuvendin Zgjedhor, duke ngjallur dyshime për shkelje ligjore e statutore dhe kurdije të Kuvendit, siç është thënë nga "opozita" e Ademit, i cili insiston për mbajtjen e Kuvendit më 6 prill madje, me gjasë, pa kundërkandidat. "Nëse dikush mendon që MKRS-ja do të bëjë kompromise në raport me standardet e qeverisjes së mirë në raport me detyrimet statutore të federatave dhe

organizatave të tjera sportive e ka gabim. Prandaj nga këtu ju bëj të qartë të gjithëve që MKRS e merr shumë seriozisht qeverisjen e mirë brenda federatave sportive dhe ne nuk do të tolerojmë asnjë shkelje dhe asnjë tejkalim të normave statutare, të rregullore të MKRS-së dhe Ligjit të Sportit në Republikën e Kosovës", ka thënë Çeku në ceremoninë e ShGSK-së.

## Ndahen çmimet për gazetarët më të mirë të sportit

PRISHTINË, 17 MARS - Ministri i Sportit, Hajrulla Çeku, mori pjesë në ceremoninë e ndarjes së çmimeve për gazetarët më të mirë të sportit "Çmimet Ali Shala 2021", organizuar nga Shoqata e Gazetarëve Sportivë të Kosovës. Faton Polisi mori çmimin për kronikën më të mirë televizive në sport, Kemajl Goca për shkrimin më të mirë, Shpend Ahmeti për fotografimin më të mirë dhe

Eljona Patriku u zgjodh raportuesja më e mirë e re në sport. Çmimin për vepër jetësore e mori gazetari Gani Begu, ndërsa çmimi post mortem iu dha kontribuuesit të madh të hendbollit të Kosovës, Ahmet Hysenaj - Petrova. Ministri Çeku, ndër të tjera, në fjalën e tij ka thënë që gazetarinë sportive MKRS-ja e konsideron partnere të

rëndësishme për zhvillimin e politikave dhe për avancimin e tërësishëm të sportit. Në këtë ngjarje morën pjesë krerët e sportit dhe të gazetarisë sportive në Kosovë, kryetari i Komitetit Olimpik të Kosovës, Ismet Krasniqi, Leonard Tase, këshilltar i presidentit të Shqipërisë, Ilir Meta, Aleksandër Çipa, kryetar i Unionit të Gazetarëve Shqiptarë, drejtuesit e



SGGSK-së të udhëhequr nga gazetari Edmond Thaçi, dekani i Shkencave Sportive në Universitetin e Prishtinës, Musa Selimi, gazetarët e

mirënjohur Defrim Methasani e Altin Sulçe, Shaban Sinani, përfaqësues të organizatave sportive dhe gazetarë sportivë.



## Manaj: E lashë Barcelonën për ambiciet e Spezias

LA SPEZIA, 17 MARS - Futbollisti shqiptar Rey Manaj u largua nga Barcelona për t'iu bashkuar ekipit italian Spezia në Serinë A. Përfaqësuesi shqiptar thotë se kishte mundësi të qëndronte në "Camp Nou", ku i ishte premtuar se do të kishte minuta për lojë edhe në ekipin e parë.

Por, në fund ai kishte vendosur të largohej përfundimisht për ta provuar një aventurë të re në Itali. "Gjatë verës së kaluar, pas një viti të kaluar dhe duke dëgjuar gjithçka në dhomat e zhveshjes, e mora vendimin të largohem dhe të provoj të luaj diku tjetër. Në ato ditë më donte

një klub tjetër i La Ligas, por Barcelona e kishte refuzuar atë ofertë. Më pas isha unë që kërkoja të largohesha. Koemann më tha se do t'i kisha rastet e mia për të luajtur, por vendosa të llogarisja në vetveten. Unë jam larguar para Griezmannit. Nëse do të

largohej më herët ai, unë do të qëndroja", ka thënë Manaj për "La Gazzetta dello Sport". "Përse e zgjodha Spezian? Ishte një bast i mirë. Një klub ambicioz që po konsolidohet. E kam kuptuar se këtu do të mund të



afirmohesha definitivisht", ka deklaruar Manaj.

## Greza: Gerrardi legjendë, e shoh si pasardhësin e Kloppit te Liverpoolia

SHIBENIK, 17 MARS - Eros Greza ka arritur shifrën e 100 ndeshjeve në kampionatin kroat. Mesfushori me tipare sulmuese ka luajtur 59 ndeshje me Lokomotivën e Zagrebit, 37 me Osijekun dhe katër me Shibenikun, në të cilën luan tash. Në këto katër paraqitje ai ka arritur që të shënojë një gol dhe të japë edhe një asistim. Vetë Greza ka folur për mediet kroate pas paraqitjes së shkëlqyer në javën e fundit. "Ndihem i kënaqur që gjeta golin kaq shpejt. Sinqerisht nuk e dija që luaja ndeshjen e 100 në kampionatin kroat. E kam zbuluar në TV, kur isha duke vozitur me makinë", shprehet fillimisht Greza. "Çfarë të them, nëse dikush do të më sugjeronte para ndeshjes nëse dua të marr një fanellë me numër 100 apo të shënoj një gol, do të zgjidhja këtë të fundit. Dhe fanella gjithmonë mund të merret më vonë", ka shtuar përforcimi i madh



dimërori i Shibenikut. Greza ka luajtur edhe për gjigantët e Rangersit. "Ishte e mrekullueshme për mua te Rangersi, një klub i madh, tifozë, traditë. Po, për fat të keq, nuk luajta derbin e famshëm për shkak të dëmtimeve. Gerrard?

Legjendë, trajneri më i mirë me të cilin kam punuar ndonjëherë. Ai jeton për futbollin, i dorëzohet plotësisht atij. E shoh me siguri si trajnerin e ardhshëm të Liverpoolit. Shpresoj si pasardhës të Jurgen Kloppit", ka shtuar Greza.

## Anelka: Ka përfunduar karriera e Messit dhe Ronaldos

MANCHESTER, 17 MARS - Nikolas Anelka, ish-sulmuesi i njohur francez, mendon se Cristiano Ronaldo dhe Lionel Messi duhet ta pranojnë faktin se tashmë karriera e tyre ka përfunduar. Lojtari i cili në karrierën e tij ka luajtur për klubet më të mëdhenj në Evropë si PSG, Arsenal, Real Madrid, Liverpool, Manchester City, Juventus apo Chelsea, insiston se ata kanë gabuar me zgjedhjet që kanë bërë këtë verë, duke kërkuar sfida të cilat në fund rezultojnë zhgënjyese për faktin se tashmë nuk janë më në kulmin e tyre. "Karrierat e tyre kanë përfunduar dhe mendoj se të dy duhet të jenë shumë të lumtur me atë që kanë arritur në 15 vjetët e fundit. Ishin në majë të botës dhe tani është normale që të ulet ritmi. Më çuditi më shumë Messi se Ronaldo. Mendoja se Messi do të ishte për shëtitje në Francë dhe Ronaldo do të kishte më shumë vështirësi në Angli, pasi për mua Premierë



Liga është kampionati më kërkuar në botë", ka thënë për "RMC Sport". "Të dy duhej të ishin treguar më inteligjentë. Kjo është ajo që u ndodh lojtarëve të cilët duan të luajnë më shumë kohë. Ata nuk u treguan të zgjuar. Duhej të mendonin që të gjenin sfida më pak të komplikuar pasi duhej t'i

merrnin vendimet e duhura për ta mbyllur karrierën në majë. Ka lojtarë të cilët nuk dyshojnë që ta mbyllin në moshën 32, 33, 34-vjeçare për të mos u kritikuar. Unë u ndala kur isha 36, por në moshën 32-vjeçare ika në Kinë", ka shtuar Anelka i cili në sezonin e fundit të karrierës luajti edhe me Mumbain në Indi.

### SHKURT

#### Trajneri i Torinos: Berisha do të jetë titullar

Etrit Berisha do të jetë përsëri titullar në Serinë A, ku Torino do të përballet në këtë fundjavë me Genoan. Konfirmimi ka ardhur nga trajneri i skuadrës, Ivan Juriç, i cili ka bërë të qartë se do të jetë gardiani kuqezi mes shtyllave në kërkimin për të marrë një fitore që do të bënte shumë më të qetë javët e fundit të kampionatit për ekipin e tij. "Berisha i konfirmuar nga minuta e parë? Po", ishte përgjigja e Juriç para gazetarëve, duke bërë të qartë se tashmë gardiani kuqezi ka fituar vend më të rëndësishëm në hierarkinë e skuadrës kundrejt Milinkoviç-Saviç.

#### Veteli infektohet me Covid, mungon në garën hapëse

Sebastian Veteli nuk do të jetë në garën hapëse të sezonit 2022. Piloti i Aston Martinit ka rezultuar pozitiv me Covid-19, një ditë para "hapjes së vikendit". Gjithsesi, skuadra e ka të identifikuar zëvendësuesin për Vettelin. Ai është Nico Hulkenberg. Hulkenbergu tani synon ndonjë befasi të mundshme në garën e Bahrainit, që është, njëkohësisht, edhe gara hapëse. Kjo do të jetë gara e parë pa Vettelin, që nga viti 2007 kur ai mungonte në European Grand Prix në Nurburging. Bahrain GP zhvillohet më 20 mars.

#### Unitedi, gati ta rëmbejë Tuchelin

Skuadra e Chelseas momentalisht është në një kaos pas sanksioneve të vendosura nga Anglia ndaj Roman Abramovichit. Manchester Unitedi është duke monitoruar me kujdes situatën dhe kërkon të përfitojë nga situata e "bluve" të Londrës. "DailyStar" bën me dije se Unitedi ka kthyer në prioritet nënshkrimin me teknikun gjerman Tuchel. Tucheli ka qenë mjaft i suksesshëm nën drejtimin e Chelseat duke fituar Ligën e Kampionëve në sezonin debutues. Bordi i "Djajve të kuq", përpos Tuchelit, po shikon edhe alternativa të tjera për zëvendësuesin e Rangnickut siç janë Mauricio Pochettino dhe Julen Lopetegui.

#### Mesfushori i Juves rezulton pozitiv me Covid

Mesfushori i Juventusit dhe Italisë, Manuel Locatelli, ka rezultuar pozitiv me Covid-19. Ish-mesfushori i Sassuolos luajti 82 minuta në humbjen 3-0 të Juventusit kundër Villarrealit në ndeshjen e dytë të 1/8-s në Ligën e Kampionëve mbrëmë. "Bianconerët" kanë njoftuar tani se mesfushori ka rezultuar pozitiv me Covid-19. "Klubi i Futbollit Juventus njofton se sot Manuel Locatelli ka rezultuar pozitiv me Covid-19. Lojtari, në marrëveshje me autoritetin lokal shëndetësor, tashmë është i vetizoluar", thuhet në një deklaratë të klubit.

## PSG-ja nuk e lejon largimin e Neymarit

Paris Saint-Germaini nuk do ta shesë Neymarin gjatë afatit kalimtar të verës. Brazilianin nuk ka arritur asnjëherë maksimumin e tij në klubin parisien për

disa sezone, duke vuajtur nga probleme të mëdha me lëndime dhe duke mos e çuar skuadrën drejt lavdisë së Ligës së Kampionëve. Eliminimi i fundit nga Real

Madridi në Ligën e Kampionëve, i cili pasoi me vërshëllimat e tifozëve në ndeshjen ndaj Bordeauxit, u përfol se Neymar do të largohet përfundimisht.

Megjithatë, mediami i njohur "Le10Sport" këmbëngul se PSG-ja nuk është e interesuar ta shesë yllin brazilian i cili mund t'i bashkohej Barcelonës.





**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria -Vlada - Government*

*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit / Ministarstvo  
Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije / Ministry of Education, Science,  
Technology and Innovation*

Në bazë Ligjit të Punës nr. 03/L-212, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 90/2010), Ligjit për Zyrarët Publik nr. 06/L-114, Ligjit për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës nr. 04/L-032, Udhëzimit administrativ nr. 02/2018 për Qendrat Burimore, Udhëzimi administrativ nr. 34/2014- Funksionimi i Shërbimit Pedagogjik-Psikologjik në Shkolla, Udhëzimit administrativ nr. 07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik dhe kërkesës së Qendrës Burimore, Departamenti i arsimit parauniversitar, rishpall:

### KONKURS

**Për vendin e lirë të punës në Qendrën Burimore për mësim dhe këshillim  
"Xheladin Deda" në Pejë**

Nr.	Pozita	vendi i lirë/zëvendësim	Nr. i pozitave
1	<i>Psikolog/e në QB "Xheladin Deda" në Pejë</i>	<b>vendi i lirë</b>	<b>1</b>

#### Punët dhe detyrat e psikologut/es

- Identifikon nxënësit të cilëve u nevojitet ndihma dhe trajtimi adekuat psikologjik;
- Përpilon teste të bazuara për diagnostikimin e vështirësive në mësimdhënie;
- Mban lidhje me ekipet profesionale të qendrës burimore;
- Këshillon nxënësit të cilët kanë nevojë për ndihmë në mësim, punë vazhduese, këshillon zgjedhjen e profesionit ose të cilët kanë nevojë për këshilla për të tejkaluar problemet personale;
- Kontribuon në lehtësimin e procesit të të nxënësit dhe promovon zhvillimin kognitiv, emocional, social dhe personal të nxënësve;
- Ofron ndihmë në tejkalimin e vështirësive të natyrës psikologjike me të gjithë akterët në shkollë;
- Vlerëson dhe interpreton çështjet që kanë të bëjnë me procesin e të nxënësit dhe zhvillimit kognitiv, emocional, social dhe personal të nxënësve.

#### Përgatitja shkollore e psikologut/es

- **Niveli master në degën e Psikologjisë – drejtimi Psikologji shkollore dhe këshillim të Fakultetit Filozofik.**

#### Kushtet e konkursit

Përzgjedhja e kandidatëve bëhet duke u bazuar në kriteret e Ligjeve që e rregullojnë fushën e arsimit: Ligji për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës, nr. 04/L-032, paragrafi 4.2 i nenit 2 të UA 34/2014- Funksionimi i Shërbimit Pedagogjik-Psikologjik në Shkolla.

**Sqarim shtesë:** – Informatat e dhëna në aplikacion konsiderohen të vlefshme vetëm nëse dëshmohen me dokumente.

– Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet t'i kenë të nostrifikuara dokumentet në MASHTI.

– Në intervistë me shkrim ftohen kandidatët që i plotësojnë kriteret e konkursit.

Kandidatët që aplikojnë duhet të jenë banorë të Republikës së Kosovës.

Periudha provuese e punës është 1 (një) vit.

#### Afati dhe mënyra e aplikimit

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik. Formulari i aplikimit i plotësuar (merret në Qendër Burimore). Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë).

Diploma e kualifikimit (ose certifikatë) certifikata në vend të diplomës duhet të jetë e noterizuar.

Dëshmi që nuk është nën hetime.

Kandidatët, dokumentet duhet ti dorëzojnë në Qendrën Burimore përkatëse ku konkurrojnë. Aplikacionet e pakompletuara nuk shqyrtohen.



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria -Vlada - Government*

*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit / Ministarstvo  
Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije / Ministry of Education, Science,  
Technology and Innovation*

Na osnovu Zakona o radu br. 03/L-212, (Službeni glasnik Republike Kosovo, br. 90/2010), Zakon o javnim službenicima br. 06/L-114 Zakon o pred univerzitetskom obrazovanju u Republici Kosovo br. 04 / L-032, Administrativnog uputstva br. 02/2018 o Resursnim centrima, Administrativno uputstvo br. 34/2014 Funksionisanje Pedagoško-psihološke službe u školama Administrativno uputstvo br. 07/2017, o regulisanju procedure konkurisanja u javnom sektoru na zahtev Resursnog centra, Departament za pred univerzitetsko obrazovanje obnavlja;

### KONKURS

**Za slobodno radno mesto u Resursnom centru za nastavu i savetovanje  
"Xheladin Deda" u Peći**

Br.	Položaj:	slobodno radno mesto/zamena	Br. pozicija
1	<i>Psihologija/ca u RC "Xheadin Deda" u Peći</i>	<b>slobodno radno mesto</b>	<b>1</b>

#### Zadaci i obaveze psihologa

- Identifikuje učenike kojima je potrebna odgovarajuća psihološka pomoć i lečenje;
- Sastavlja testove zasnovane na dijagnosticanju poteškoća u nastavi;
- Održava vezu sa profesionalnim timovima resursnog centra;
- Savetuje učenike kojima je potrebna pomoć u učenju, kontinuiranom radu, savetuje izbor profesije ili koji imaju potrebe za savet za prevazilaženje ličnih problema;
- Doprinosi u olakšavanju procesa učenja i podstiče kognitivni, emotivni, socijalni i lični razvoj učenika;
- Pruža pomoć u prevazilaženju teškoća psihološke prirode kod svim akterima u školi;
- Ocenjuje i tumači pitanja vezana za proces učenja i kognitivni, emocionalni, socijalni i lični razvoj učenika.

#### Školska sprema psihologa

- **Nivo master Psihologije - smer Školska psihologija i savetovanje Filozofski fakultet.**

#### Uslovi konkursa

Izbor kandidata se vrši na osnovu kriterijume Zakona koji regulišu oblast obrazovanja: LUakon o preduverzitetskom obrazovanju u Republici Kosovo, br. 04/L-032, stav 4.2 i član 2 AU 34/2014 Funksionisanje Pedagoško-psihološke službe u školi.

**Dodatno pojašnjenje:** -Informacije prikazane u aplikaciji smatraju se validnim samo u koliko budu potkrepljeni dokazom

– Osobe koje su diplomirale van Kosova moraju dostaviti da je izvršena nostrifikacija dokumenta i MONTI-a.

- Na intervju će biti pozvani samo kandidati koji ispunjavaju kriterije konkursa.

Kandidati koji apliciraju moraju biti stanovnici Republike Kosovo.

Probni period rada je 1 (jedna) godina.

#### Rok i način apliciranja

Konkurs ostaje otvoren 15 dana od objave konkursa u medijima javnog informisanja.

Popunjena formulara za aplikaciju (može se dobiti u Resursne Centre).

Lični dokument (lična karta ili pasoš).

Diploma kvalifikacije (ili certifikat) certifikat umesto diplome mora biti noterizovan;

Dokaz da nije pod istragu

Kandidati, dokumenta moraju dostaviti u relevantni Resursni centar u kojem konkurišu. Ne kompletirane aplikacije neće se uzeti na razmatranje.



## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "Tap- Rrap" SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 71106381si dhe me nr. fiskal: 601177943 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Tap- Rrap" D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 71106381 nr. fis: 601177943 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "Tap- Rrap" L.L.C. has come to the decision to quit its business: 71106381 nr. fis: 601177943 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

# Lokali me qira

Lëshohet lokali me qira. Lokali ka 75 m2. Lokali gjendet tek "REB BULLI", në Prizren. Për informata mund të na kontaktoni në këta numra të telefonit:  
**044-514-373 dhe 044-199-707.**

RESTAURANT

# SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

## LAJMËROJMË

Bashkëpronarët Shaqir Rasma, Dragoslav Petyroviq dhe Svetislav Petroviq, nga Fshat Mushnikovë Komuna Prizrenit, si Blerësit potencial se, ne Bashkëpronarët Novica Adxhellkoviq, Mlaxhan Fuksanoviq, Illij Mladenoviq, Stanislavka Mitroviq de Zivko Mlladenoviq, si bashkëpronarë ligjor të ngastrave kadastrale me numër P-71611071-02837-1, sipërfaqe të përgjithshme prej 351 m2, në Zonën Kadastrale Mushnikovë, **po i SHESim - pjesët tona bashkëpronësore.**

Në këtë mënyrë i ofroj bashkëpronarëve, poqë se janë të interesuar për blerje, të më lajmërohen në afat prej 30 ditëve, në adresë: rr. " Fehmi LLadrovci " nr.70 – Prizren.

Një herri informoj se, e kam Blerësin potencial i cili brenda afatit prej 30 ditëve do ta paguan çmimin e përgjithshëm prej 5.000.00 € (Vpeseqind mijë euro) me para të gatshme-në kesh.

Telefoni kontaktues:+383 (0) 44-351-471

## &gt;&gt; SHPALLJE TË VOGLA &lt;&lt;

► "Town" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. të biznesit 810840589.

► Hamdi Hajra shpalle te pavlefshme deftesen e shkolles fillore "Skenderbeu".

► Elmedina Istrefi shpalle te pavlefshme deftesen e shkolles fillore "Musa Hoti" nga klsa 6-9.

► Zymrete Fazli gjeloshaj shpalle te pavlefshme deftesen e shkolles fillore "Fazli Greicevci"

► "Donito" Sh.p.k shpalle te humbur certifikaten e TVSH-se me nr 330401357.

► Yllka Zeqiri shpalle te pavlefshme Diplomen e SHMLM "Dr xheladin Deda"

► Refki Peci shpalle te pavlefshme deftesen dhe diplomen e SHMLT "Arkitekt Sinani"

► Lirie Pllana shpalle te pavlefshme deftesen e shkolles fillore nga klasa 1-5.

► Elvidon Sadriu Shpalle te pavlefshme licensen e punes te leshuar nga OIK me nr 4/1128

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients (Listed in alphabetical order)

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



## PASHTETË PULE

gluten free

100% mish pule



cilësi e garantuar

pa konservues